



**Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës**



Nr. 02-020-400/16-46362 dt. 31.08.2022

Bazuar në nenin 11,12 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 shkronja C dhe neni 40,të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 34.pika 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit-Gllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë **31.08.2022**, të miratoi këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha

Neni 1

Më këtë Vendim formohet Komisioni për plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve, të cilin Komision e përbejnë tre (3) anëtar nga Ekzekutivi i Komunës të cilët i propozon Kryetari i Komunës, tre (3) anëtar nga Kuvendi i Komunës nga subjektet e ndryshme të përfaqësuar në Kuvend, dhe një (1) anëtar nga shoqëria civile i propozuar nga Kryetari i Komunës si vijon:

1. Violeta Baleci– kryetar/e nga ekzekutivi
2. Arjanit Balaj - anëtar nga ekzekutivi
3. Besart Bajrami - anëtar nga ekzekutivi
4. Valentina Leku - anëtar nga kuvendi
5. Mehedin Salihu - anëtar nga kuvendi
6. Drin Halilaj - anëtar nga kuvendi dhe
7. Sulltane Mulaj - përfaqësues nga shoqëria civile, anëtar,

Neni 2

Komisioni ka për detyrë të bëjë plotësim ndryshimit të Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha, duke e harmonizuar këtë rregullore me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 3

Komisioni për plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha, punën e tyre duhet ta kryejnë me profesionalizëm të lart dhe përkushtim.

Neni 4

Komisioni për plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha, i dërgon Kuvendit të Komunës për miratim këto ndryshime, pas përfundimit të gjitha procedurave të parapara me ligj.

Neni 5

Mandati i këtij komisioni vazhdon deri në miratimin e këtyre ndryshimeve nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit.

Neni 6

Ky vendim I buxhetit ,hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendit të Komunës së Drenasit dhe nënshkrimi I Kryesuesit të Kuvendit Milaim Hajdari.

Vendimi i dërgohet:
Zyrës së Kryetarit ;
Drejtorisë Përkatëse;
Zyrës së Kuvendit;
Arkivit;



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Milaim Hajdari